



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1201 Prot.

Tiranë, më 01.10 2018

**VENDIM Nr. 194, datë 25.09.2018**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.09.2018, pasi shqyrtoi Raportin paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të dyshemesë me mozaik, të zbuluar në kuadër të projektit "*Restaurimi i Xhamisë Mbret dhe Teqesë së Helvetive në qytetin e Beratit*", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Berat.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të dyshemesë me mozaik, të zbuluar në kuadër të projektit "*Restaurimi i Xhamisë Mbret dhe Teqesë së Helvetive në qytetin e Beratit*", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Berat.
2. Të kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Berat konservimi dhe dokumentimi i strukturave murore dhe mozaikut të zbuluar.
3. Të devijohet kanali i drenazhimit në këtë zonë me qëllim mos dëmtimin e këtyre strukturave.
4. Të mbulohen mozaiku dhe strukturat e zbuluara me qëllim ruajtjen e tyre nga dëmtimet e mundëshme, si dhe të vendoset një tabelë informuese në lidhje me to.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rudina Zoto", enclosed within a large, loopy blue oval.

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@usha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@usha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)